

Trajnim në temë “Të drejtat e njeriut dhe standardet juridike për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë”

Nga 12 deri 14 qershor të vitit 2008 në Ohër u mbajt trajnim në temë “Të drejtat e njeriut dhe standardet juridike për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë”.

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të fitojnë dituri për konceptet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (karakteristika, historia dhe mekanizmat), në trajnim morën pjesë 17 përfaqësues nga organizatat joqeveritare nga Resnja, Manastiri, Struga dhe Ohri dhe 8 përfaqësues nga institucionet lokale në Resnjë dhe Strugë. Trajnimin e realizuan Igor Tasevski dhe Taliya Baboska nga Qendra për Iniciativa Qytetare, Prilep. Struktura e pjesëmarrësve ishte e balancuar shkëlqyeshëm nga aspekti i moshës, gjinisë, nacionalitetit dhe arsimimit. Prandaj edhe diskutimet ishin interesante, ndërsa pyetjet e parashtruara të frymëzuara nga vetë ligjërimit. Te disa pjesëmarrës pyetjet shërbenin për plotësimin e disa diturive që tani i dinin. E rëndësishme për këtë trajnim ishte pjesëmarrja e Liljana Ilievskës, zëvendëse e Avokatit të Popullit nga zyra rajonale në Manastir. Komentet dhe këshillat e saj ishin të mirëseardhura nga gjithë pjesëmarrësit.

Në përmbajtjen e trajnimit së pari u shpjegua rëndësia e pakicave nacionale gjegjësisht etnike, religjioze dhe gjuhësore në disa shtete evropiane. Pastaj u prezantua lista e lirive dhe të drejtave elementare të njeriut të cilat nën kushte plotësisht të njëjta duhet ti posedojnë edhe shumica edhe qytetarët e bashkësive etnike jo shumicë. Lidhja e kornizës juridike ndërkombëtare me atë të vendit për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive duke i vënë aksent të posaçëm ligjeve nga legjislatura e vendit i parapriu pjesës së fundit në kuadër të së cilës u përfshi sistemi i mbrojtjes së të drejtave të anëtarëve të bashkësive si pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Atmosfera e punës ishte e shkëlqyer dhe plotësisht e përkrahur me punë në grupe dhe një sërë ushtrimeve praktike për zbatimin e informatave të reja.

Trajnimit u organizua nga Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit nga Resnja dhe Struga (Qendra për përkrahjen e bashkësisë Resnjë dhe Shoqata për zhvillimin e aktivizmit “Akva” Strugë, ish Qendrat për Përkrahje të OJQ-ve).